



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:057336  
Datë: 11.10.2018  
Numri i dokumentit: 00144505

P.nr. 1031/2016

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal,** gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuareve I. B. nga Prizreni, dhe N. U. nga Prishtina me mbrojtësin e tij av.B. T. nga Prishtina, për shkak të veprave penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-es, dhe vepra penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-es, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.300-2/2016 të dt.17.05.2016, pas mbajtjes së seancës te shqyrtimit kryesor gjyqesore, në prezencën e Prokurorit te shtetit në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit, me datë **18.09.2018**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

## **A K T G J Y K I M**

1. I akuzuari **I. B.**, nga i ati H., e ëma Sh., e vajzërisë Xh., i lindur më dt. *data e lindjes...* në fsh.M. KK Prizren, tani me banim ne Prizren ne rr... nr...., i martuar baba i 2 femijeve, ka të kryer shkollen fillore, i pa pune, eshte i gjendjes se dobet ekonomike, boshnjak, shtetas i R. së Kosoves.

2.I akuzuari **N. U.**, nga i ati B., e ema A., e vajzerise Z., i lindur me *data e lindjes...* ne Prishtine, ku edhe tani jeton ne rr.... nr..., i pamartuar, ka te kryer fakultetin, hoteljer, i gjendjes se mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i R.Kosoves.

## JANË FAJTOR

I pandehuri I. B.

### I

Se me dt.30.01.2016, rreth ores 08,22 min, ne P.-R. Komuna e Prizrenit, ne afersi te tunelit te pare, duke mos iu permbajtur dispozitave te komunikacionit ne rruge, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jeten e njerezve dhe pasurine, vepron ne kundershtrim me nenin 54 te LSKRR-se, duke mos ia pershtatur shpejtesine e levizjes kushteve ekzistuese te komunikacionit, rruge e rreshqiteshme, ne ate menyre qe duke drejtuar automjetin e markes"VW Golf 2", me ngjyre te kuqe, me targ.te regjistrimit *numri i targës...*, kurr arrin ne vendin kritik, ne nje kthese te ashper majtas, humb kontrollin ndaj automjetit te tije dhe kalon jashte rruges ne anen e djathte, ku nga pakujdesia me pjesen e perpareme te anes se djathte te automjetit te tije, e godet nje shkemb prane rruges, me qrast si pasoje perpos demeve materiale ne automjet, lendime te lehta trupore peson bashkeudhetarja ne automjetin e tije-e demtuara F. B., lendime keto te pershkruara si ne mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor te dt.07.05.2016,

-kësodore ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së.

I pandehuri N. U.,

### II

Se me date, kohe dhe vend te njejte te pershkruar si ne dispozitivin nen 1 te kesaj aktakuze, duke mos iu permbajtur dispozitave te komunikacionit ne rruge, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jeten e njerezve dhe pasurine, vepron ne kundershtrim me nenin 54 dhe 126 te LSKRR-se, duke mos ia pershtatur shpejtesine e levizjes kushteve ekzistuese te komunikacionit, dhe duke mos e mbajtur distancen e nevojshme/distance e sigurise/, ne ate menyre qe duke drejtuar automjetin e markes"BMW X3", me ngjyre te zeze, me targ.te regjistrimit *numri i targës...*, kurr arrin ne vendin kritik, ne nje kthese te ashper majtas, nga pakujdesia me pjesen e perpareme te automjetit te tije, e godet ne pjesen e pasme automjetin e markes"Golf 2", me ngjyre te kuqe, me targa te regj. *Numri i targës...*, te cilen e drejtonte i pandehuri I. B., i cili ishte i ndalur pasi qe me pare ishte vete-aksidentuar, me qrast si pasoje perpos demeve materiale ne automjete, lendime te lehta trupore peson bashkeudhetarja ne automjetin e te pandehurit I. B.-e demtuara F. B., lendime keto te pershkruara si ne mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor te dt.07.05.2016,

-kësodore ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 41, 42, 46, 73, 74, 75 e 76 te KP-es dhe 365 të KPPK-ës, te akuzareve iu shqipton,

**Te akuzuarit I. B.,**

### **D E N I M M E G J O B E**

Per vepren penale si ne dispozitivin nen 1 te aktakuzes ne shumen prej **200,00 /dyqind/ euro, te cilen shume te denimit eshte i obliguar qe te paguaje ne afate prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi, nese i akuzauri nuk e paguan denimin me gjobe as me detyrim, i njejti do te zevendesohet per qdo 20 euro nje dite burgim, respektivisht 10 dite burgim.**

**Te akuzuarit N. U.,**

### **D E N I M M E G J O B E**

Per vepren penale si ne dispozitivin nen 1 te aktakuzes ne shumen prej **200,00 /dyqindë/ euro, te cilen shume te denimit eshte i obliguar qe te paguaje ne afate prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi, nese i akuzauri nuk e paguan denimin me gjobe as me detyrim, i njejti do te zevendesohet per qdo 20 euro nje dite burgim, respektivisht 10 dite burgim.**

Te akuzuarit obligohen që ti paguajne shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, sado qe te jen ato, ne emer te super ekspertizes te komunikacionit rrugor ne menyre solidare shumen prej **450,00 euro**, ndersa në emër të paushallit gjygjësor secili veç e veç shumën me nga **30 euro**, si dhe ne emer te kompenzimit per viktimat e krimit secili shumen veq e veq me **nga 30 euro**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E demtuara F. B. nga Prizreni rr... nr..., per realizimin e kerkeses pasuroro – juridike udhezohen ne kontest te rregullt civilo-juridik,

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr.300-2/2016 te dt.17.05.2016 kunder te akuzuarve I. B. nga Prizreni dhe N. U. nga Prishtina, me mbrojtesin e tij av.B. T. nga Prishtina, për shkak të veprave penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-es, vepra penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-es,

Prokurori i Shtetit ne Prizren Besim Susuri ne fjalen e tije perfundimtare deklarone: Pas seancave gjyqesore ne qeshtjen penale kunder te pandehurve I. B. dhe N. U. te cilet prukuroia ne Prizren i ngarkon per veper penale te rrezikimit te trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur

me par.1 te KP-se, per ta vertetuar gjendjen faktike jane ndermare disa veprime te propozuara si ne aktakuze dhe te tjera te paraqitura si te domosdoshme gjate shqyrtimeve gjyqesore, eshte bere ekspertiza e komunikacionit rrugor nga eksperti M. M., me te cilen ekspertize gjate shqyrtimit palet nuk jane pajtuar dhe kane propozuar ekspertize te re, e cila eshte bere nga eksperti i komunikacionit A. K., ku sipas ketij eksperti eshte konstatu se shkaktar i aksidentit jane te dy te pandehurit si ne aktakuze, e me pas ne kete situatë kunderthenese me te dy ekspertizat eshte kerkuar nevoja super ekspertiza me qellim te vertetimit te drejte te qeshtjes faktike si shkaktar te vertet te aksidentit, e cila super ekspertize eshte bere nga komisioni i eksperteve te Univerzitetit te Prishtines "Hasan Prishtina", fakulteti i inxhinerise mekanike ne Prishtine, nga ku eshte konstatuar se shkaktar i aksidentit ne trafik jane dy pjesemaresit me veturat e tyre dhe ate vetura A, eshte se e ka goditur shkemborin e rruges duke mos treguar kujdes te shtuar ne kthese ne afersi te tunalit, duke pasur parasyshe kushtet atmosferike qe kane mbizotruar si gjendje e lagur e asfaltit, me ngrica fhe afer tunelit, kthese e ashper, te gjitha keto te paralajmruara me shenje vertikale. Ndersa per leshimet e vozitesit te vetures B, kane kontribuar leshimet se nuk e ka mbajtuar distancën e mjaftueshme te sigurise ne mes te veturave. Konsideroj se ne rastin konkret ne teresi eshte vertetuar gjendja faktike si ne dispozitivat e kesaj aktakuze se te pandehurit I. B. e N. U. jane shkaktar te aksidentit ne trafik dhe kryes te veprave penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-se, andaj kerkoj qe gjykata te pandehurit ti shpalle fajtor dhe ti denoj sipas ligjit.

I akuzuari I. B. ne fjalen e tije perfundimtare deklaronte: sa i perket vepres penale per te cilen me ngarkon aktakuza si ne shqyrtimin fillesatër ate te dytin dhe ne shqyrtim kryesor, e ne fjalen time mbrojtese qe kam deklaruar, sa i perket aksidentit ne trafik une nuk e ndiej veten pergjegjes e as fajtor nga se une nuk jam shkaktar i aksidentit.

Mbrojtësi i te akuzuarit N U. av. B. T., ne fjalen e tije perfundimtare deklaronte: pas analizimit e konstatimit dhe sintetizimit te tersishem te shkresave te lendes, rrjedhjes se rastit dhe lidhjes logjike dhe faktike bazuar ne rregullat e trafikut dhe dispozita te tjera, logjikshem bindshem dhe pertej qdo dyshimi vertetohet pabazueshmeria e akuzes. Policia rrjedhimisht prokuroria ka qene totalisht subjektiv dhe jo profesional, dhe nga deklarata e policit ne vendin ne ngjarjes qe i ka thene vete te pandehureve se sot 4 here i kemi thirur kompanin e pastrimit te rrugeve dhe nuk kane ardhur dhe per qfardo dyshimi ne kete deklarate propozojme perseri degjimin e deshmitarit policit N. Q.-polic i trafikut, ku nga raporti i policit ne vendin e ngjarjes vertetohet se rruga ka qene me ngrica e lageshte, por ka harruar i njejti me pershkruar edhe gjerësin e rruges dhe gjatesine e saj, si dhe trashesine e akullit. Nga te tri ekspertizat vertetohet qe te dy automjetet ne te njeten vi levizese kane dalur nga rruga per shkak se konfiguracioni i rruges dhe pjerretesia e saj dhe akulli e kane determinuar situaten dhe te dy vozitesit jo per nga shpejtesia po per shkak te akuillit veturat i kane pasur jashte kontrollit, dhe nga ekspertet vertetohet qe ka qene levizje e ngadaleshme, ku thuhete se maksimumi i i vozitjes ka qene 30 km ne ore, ndersa vozitja ka qene deri ne 25 km ne ore para aksidentit. Eshte alogjik dhe joprofesional ekspertiza sa i perket punes se tije si ekspert. Nga raporti i ekspertit shihet se rruga ishte 7 metra e gjate, dhe sikur te kishte frenuar vetura e pare dhe ajo e dyta kishte per te anashkaluar mos te godas bregub gjegjesisht veturen e pare, dhe vetura e pare nuk ka frenuar dhe ka dalur jashte rruge dhe ne te njeten menyre pas disa qasteve ka vepruar edhe vetura e dyte, ka dalur nga rruga dhe ka reshqitur dhe e ka goditur veturen e pare. Nga raportet e eksperteve askund nuk verehen gjurmëte e frenimit-nuk knstatohen te njejtat, arsyeja se te frenimi mbi akulle nuk ka gjurme dhe nuk ka frenim, nga se ka qene akull dhe aksidenti i shkaktuar eshte per shkak te akullit ne rruge. Vendi ku eshte shkaktuar aksidenti edhe ne

mujain korrik eshte hije ndersa ne janar ne ora 08,22 minuta, edhe kur ska akull gjithmon ka lageshti per shkak te rrjedhjes se ujit nga kodra, per kete sa i perket aksidentit ne trafik fajesine nuk mund ta barte asnjeri nga te pandehurit, por fajsi bie mbi mirmbajtesine e rrugeve-kompania, per shkak te rrethaneve dhe kushteve te rruges. Per kete arsye gjykates i propozoj qe te refuzoje kete akuze per shkak se nuk eshte e bazuar ne gjendjen faktike respektivisht te gjitha rrethanat qojne ne aktgjykim lirues, nga se rrethanat e perjashtojne pergjegjesine e te akuzuarëve, ne te kunderten ne se nuk refuzon gjykata kete akuze i propozoj qe te beje plotesimin e ekspertizes, ndegjimin e kryesuesit te super ekspertizes, dhe degjimin e policit hartues nga vendi i ngjarjes.

I akuzuari N. U. ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi: ne teresi e mbeshtes fjalen perfundimtare te mbrojtjesit tim av. B. T., asgje nuk kam per te shtuar.

I akuzuari I. B. ne shqyrtimin kryesor ne mbrojtjen e tij deklaroi: ne te gjitha fazat e procedures penale qe nga shqyrtimi i pare fillestarë, sa i perket vepes penale per te cilen e ngarkon aktakuza nuk e pranon fajesine per vepren penale rrezikim i trafikut publik ngase per kete veper nuk e ndien vehten fajtorë.

I akuzuari N. U. ne mbrojtjen e tij deklaroi: sa i perket aksidentit ne trafik eshte vertet se une duke e drejtuar veturen time te markes "BMW", ishte nje kthese rruga pak lageshti dhe me ngrica, kam frenuar dhe e kam goditur nga mbrapa veturen "Golf", une nuk e ndiej vehten fajtor per aksidentin e shkaktuar ngase vetura para meje e markes Golf, veç ka qene e aksidentuar duke e goditur shkembin anesor, dhe ka qene i ndalur ne rruge si dhe shkaktar i akidentit duhet te jete kompania e cila nuk e ka mirembajtur rrugen sa i perket kushteve dhe rrethanave te saj.

Gjykata ne shqyrtimin kryesor i administroi te gjitha provat e nevojshme dhe pas analizimit te seciles prove veç e veç dhe ne baze te te gjithave vertetoi kete gjendje faktike:

Ne teresi u vertetua se i akuzuari I. B. se me dt.30.01.2016, rreth ores 08,22 min, ne P.-R. Komuna e Prizrenit, ne afersi te tunelit te pare, duke mos iu permbajtur dispozitave te komunikacionit ne rruge, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jeten e njerezve dhe pasurine, vepron ne kundersizim me nenin 54 te LSKRR-se, duke mos ia pershtatur shpejtesine e levizjes kushteve ekzistuese te komunikacionit, rruge e rreshqiteshme, ne ate menyre qe duke drejtuar automjetin e markes "VW Golf 2", me ngjyre te kuqe, me targ.te regjistrimit *numr i targës...*, kurr arrin ne vendin kritik, ne nje kthese te ashper majtas, humb kontrollin ndaj automjetit te tije dhe kalon jashte rruges ne anen e djathte, ku nga pakujdesia me pjesen e perpareme te anes se djathte te automjetit te tije, e godet nje shkemb prane rruges, me qrast si pasoje perpos demeve materiale ne automjet, lendime te lehta trupore peson bashkeudhetarja ne automjetin e tije-e demtuara F. B., lendime keto te pershkruara si ne mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor te dt.07.05.2016,

Ne teresi u vertetua se i akuzuari Nu U. se me date, kohe dhe vend te njejte te pershkruar si ne dispozitivin nen 1 te kesaj aktakuze, duke mos iu permbajtur dispozitave te komunikacionit ne rruge, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jeten e njerezve dhe pasurine, vepron ne kundersizim me nenin 54 dhe 126 te LSKRR-se, duke mos ia pershtatur shpejtesine e levizjes kushteve ekzistuese te komunikacionit, dhe duke mos e mbajtur distancen e nevojshme/distance e sigurise/, ne ate menyre qe duke drejtuar automjetin

e markes "BMW X3", me ngjyre te zeze, me targ.te regjistrimit *numri i targës...*, kurr arrin ne vendin kritik, ne nje kthese te ashper majtas, nga pakujdesia me pjesen e perpareme te automjetit te tije, e godet ne pjesen e pasme automjetin e markes "Golf 2", me ngjyre te kuqe, me targa te regj. *numri i targës...*, te cilen e drejtonte i pandehuri I. B., i cili ishte i ndalur pasi qe me pare ishte vete-aksidentuar, me qrast si pasoje perpos demeve materiale ne automjete, lendime te lehta trupore peson bashkeudhetarja ne automjetin e te pandehurit I. B.-e demtuara F. B., lendime keto te pershkruara si ne mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor te dt.07.05.2016,

Gjykata kete gjendje faktike e ka vertetuar edhe nga provat materiale, deklarata e te pandehurit I. B. e dhene ne stacionin policor te trafikut ne Prizren me dt.30.01.2016, deklarata e te pandehurit N. U. e dhene ne stacionin policor te trafikut ne Prizren me dt.30.01.2016, ekspertiza e komunikacionit rrugor te dt.19.02.2016, nga eksperti i trafikut M. M., ekspertiza e ekspertit te komunikacionit A. K. te dt.25.08.2017, super ekspertiza e komisionit te eksperteve – fakulteti i inxhinjeris mekanike ne Prishtine, me nr.0108 te dt.15.05.2018, raporti mjekesor i spitalit rajonal ne Prizren, ne emer te F. B. me nr.728 te dt.30.01.2016, nga dr.K. K., raporti mjekesor i spitalit rajonal ne Prizren ne emer te F. B. me nr.728 te dt.30.01.2016 nga dr.K. K., raporti mjekesor i spitalit rajonal ne Prizren ne emer te D. B. me nr.728 te dt.30.01.2016, nga dr.K. K., ekspertiza mjeko ligjore te dt.07.05.2016, nga eksperti mjeko ligjor dr.N. U..

Deshmitarja – e demtuara F. B. ne deshmin e saj deklaror: ditën kritike me dt.30.01.2016, kam qene ne veture me babain, nenen dhe motren time, duke e drejtuar veturen babai im jemi nisur per ne fsh.M. KK Prizren, edhe pse shpejtesia ishte normale, une kam qene mbrapa ne veture dhe per nje moment kam ndier goditjen nga mbrapa ne veturen tone ku nga kjo goditje une kam pesuar lendime trupore e me pas vetura jone eshte bartur dhe eshte mbeshtetur per shkembim anesor te rruges. Une kam qene e ulur mbrapa ne veture me teper kah pjesa e majte e mbrapme e vetures, dhe nga kjo goditje kam pesuar lendime trupore ne qafë, une nuk e di se kush e ka lajmeruar policin, por e di mire qe ne vend te ngjarjes ka ardhur ndihma e shpejte dhe na ka derguar per ne spital te Prizrenit.

Deshmitarja –D. B. ne deshmin e saj deklaror: ditën kritike me dt.31.01.2016, isha duke shkuar me veture per ne fsh.M. se bashku me bashkeshortin tim I., i cili e drejtonte veturen dhe dy vajzat e mia te cilat ishin mbrapa ne veture, rruga ishte me lageshti, dhe kishte ngrica, ishte rruga nje kthese para hyrjes ne tunel edhe pse ne perpara nuk kemi pasur asnje veture vetem se kurr e kam ndegjuar nga mbrapa se vetura jone eshte goditur dhe ate ne pjesen e mbrapme te majte, vetura jone nga goditja eshte bartur zhag dhe sa me kujtohet e ka goditur shkembim anesor te rruges, edhe pse une kam qene e lidhur me rryp te sigurise nuk kam pasur lendime trupore, por lendime kane pesuar dy vajzat e mia, per nje moment ka ardhur ne vend te ngjarjes ndihma e shpejte na morri dhe na dergoi me autoambulanc ne spital te Prizrenit.

Deshmitarja – F. B. ne deshmin e saj deklaror: me kujtohet se me dt.30.01.2016, isha me familjen time duke udhetuar me veture per ne fsh.M. ku veturen e drejtonte babai im I., edhe pse me kujtohet se rruga ka qene pak lageshti, nje kthese para tunelit, une kam qene e ulur ne pjesen e mbrapme te djathte te vetures. Nga goditja une nuk kam pasur lendime trupore por kam pasur frike dhe stres, sa me kujtohet mua askush nuk eshte afruar te ne as te vetura jone as te prinderit e mi.

Eksperti i trafikut M. M., deklaror: edhe pse e kam dorezuar me shkrim ekspertizen e komunikacionit te njejten do ta elaboroj gojarisht ne cilesin e ekspertit, konstatoj se leshimet kryesore kane ardhur dhe kane ndikuar deri te aksidenti si leshim primar i vozitesit te BMW, i cili ka levizuar me shpejtesi te papershtatshme per kushtet e rruges, rruga ka qene e laguar, e rreshqitshme me kthesa te njepasnjeshme, ku vetura e markes BMW ka levizuar mbrapa vetures Golf, dhe si leshim sekondar ka qene shpejtesia jo e pershtatshme e cila e ka ndjekur

veturen Golf ne distanc te vogel nuk ka lën hapësire te sigurise per ta ndal veturen para vendit te aksidentit me ç'rast ka ardhur deri te goditja. Sipas ligjit vozitesi i vetures BMW eshte i obliguar qe te mbaj distancen e mjaftueshme te mjetit para tije ne menyre qe ti shmanget goditjes dhe aksidentit. Sipas mendimit tim ne rastin konkret perjashtohet pergjegjesia e vozitesit te vetures Golf, sepse i njejti ne asnje menyre nuk ka bere leshimin qe lidhet me ndodhjen e aksidentit, i njejti ka qene ne shiritin e tije te rruges, nuk e ka nderruar shiritin e levizjes dhe nuk ka dalur para vetures BMW, si dhe nuk ka frenuar vullshem, me perjashtim se vetura BMW ne rastin konkret dhe ne vendin kritik nuk e ka mbajtur distancen e mjaftueshme para vetures Golf, me ç'rast edhe ka shkaktuar aksident trafiku. Nga fotot ne vendin e aksidentit te raportit te policis si pershkrim i aksidentit ku tregojne poziten e veturave pas aksidentit, kurse sa i perket vetures Golf nuk mund te japi supozime se e njejta a ka rreshqitur apo jo ne rruge para goditjes apo pas aksidentit.

Eksperti A. K., deklaroi: edhe pse e kam dorezuar me shkrim ekspertizen e komunikacionit si ekspert te njejten e elaboroj, pas analizave detale te shkresave te lendes, ekspertizes te kolegut M. M., dhe pas daljes ne vendin e aksidentit kam ardhur ne perfundim si vijon: deri te aksidenti ka ardhur si pasoje e 3 faktoreve, 1, faktori rruge, ne vendin kritik rruga eshte me kthesa te njepasnjeshme, me konfiguracion malor ne te dy anet e rruges me shkembinjte te larte, gjate kohes se dimrit rruga din me qene deri ne oret e vona te dites me ngrica, te dy automjetet kane levizur ne te njejtin drejtim, pika e goditjes 1 e 2 e paraqitur nga raporti i policis nenkupton automjeti Golf eshte goditur me shkembinj ne anen e djathte te rruges si pike e pare, pika e dyte paraqet goditjen e automjetit BMW me automjetin Golf-2, ne anen e mbrapme te tije. Vetura e markes Golf per shkak te rreshqitjes nga rruga me lageshti dhe ngrica ka goditur shkembinj ne anen e djathte te rruges me ç'rast ka pesuar nje dem te vogel material ne anen e djathte te perparme te vetures. Vetura e markes BMW eshte goditur ne pjesen e perparme te tije dhe ate ne pjesen e pasme te vetures Golf, ku kjart verehet pjesa e demtuar e anes se djathte te vetures Golf, nga pjesa e perparme e majte e vetures BMW edhe pse vetura Golf nuk ka qene ne levizje, ka qene i ndalur ne shiritin e djathte te komunikacionit, andaj edhe kam konstatuar se ne aksident kane qene 3 faktoret te cilet edhe e kane sjellur deri te aksidenti. Si faktor i 3 nenkupton ngricat ne rruge, vozitesi i vetures Golf ka bere vozitje te pakujdesshme ne moment kurr ka hyre ne rrugen me ngrica ka humbur kontrollin mbi drejtimin e vetures se tije, me ç'rast ka dalur jashte rruges dhe me pjesen e perparme te djathte e ka goditur shkembinj anesor te djathte, gjithashtu edhe vozitesi i vetures BMW ka bere vozitje te pakujdesshme, per shkak se rruga ka qene me ngrica, ka humbur kontrollin mbi veturen e tije, deshton ta ndal veturen e tije dhe me pjesen e perparme e godet ne pjesen e mbrapme veturen Golf, me ç'rast edhe shkaktonte aksident trafiku. Per shkak se dy ekspertizat e komunikacionit kane ndryshime sa i perket mendimit dhe konstatimit te dy eksperteve te trafikut, gjykata sipas detyres zyrtare ka kerkuar super ekspertize dhe ate nga komisioni i eksperteve te komunikacionit – Instituti i inxhinjeris mekanike ne Prishtine, ku e njejta super ekspertize si perfundim ka konstatuar: per shkaktimin e aksidentit vetura A, me shkembore ka kontribuar per shkak te leshimeve te drejtuesit te vetures Golf, nuk ka treguar kujdes te shtuar ne kthese ne afersi te tunelit, rruga me gjendje e lagur, pjeserisht me ngrica, kthesa e ashper, te gjitha keto te paralajmeruara me shenje vertikale te trafikut, kurse vetura B, vozitesi i vetures nuk ka mbajtur distance te mjaftueshme te sigurise, gjegjesisht percjellja me distanc tejet e shkurter e automjetit paraprak.

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e te akuzuarve I. B., N. U., me mbrojtjesin e tij av.B. T., te njejtëve nuk ia fali besimin, pasi qe mbrojtja e tyre ka per qellim ti shmanget pergjegjesisë penale-juridike, per veprat penale rrezikim i trafikut publik. Mbrojtja e tyre ishte ne kundërshtim te plote me provat materiale, e ne veqanti me ekspertizat e eksperteve te komunikacionit – superekspertizen e komisionit te eksperteve, si dhe shkresat e tjera materiale, raporti nga vendi i aksidentit bashke me fotoalbumin, te cilat u administruan gjate shqyrtimit

gjyqesor, andaj te akuzuarit gjykata i shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin-denimin e pershkruar si ne dispozitivat e ketij aktgjykimi, duke e vertetuar ne teresi pergjegjesine e tyre penalo-juridike, pasi qe nuk eshte gjetur asnje rrethane te cilat do ta perjashtonin eventualisht pergjegjesine e tyre.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke e gjetur si rrethane posaqerisht renduese, shkallen e pergjegjesis penale, intenzitetin e rrezikimit, si dhe rrethanat nen te cilat eshte kryer vepra penale nga ana e te akuzuarëve se motivi per kryerjen e ketyre veprave penale ka qene moskujdesi i shtuar gjate drejtimit te veturave dhe mosrrespektimi i shenjave te trafikut, mospershtatjen kushteve dhe rrethanave te rruges te cilat edhe shkaktuan aksidentin ne trafik dhe rrezikimin e trafikut publik, e si rrethane lehtesuese ne kuptim te nenit 74, 75, 76 gjykata morri per baze edhe faktin se te akuzuarit kane bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tyre ka qene vullnetar, gjate shqyrtimit gjyqesor kane pasur qendrim tejet korrekt, gjere me tani nuk ka qene te gjykuar, do te thote se nuk ra ne kundërshtim me normat pozitive te shoqerise, sjellja e mire e tyre pas kryerjes se veprave penale, keshtu qe denimi i shiptuar si ne shqiptim te ketij aktgjykimi, eshte ne proporcion te plote me shkallen e pergjegjesis penale-juridike te te akuzuarëve, andaj kjo mase sanksionuese do te ndikojte te te akuzuarit qe ne te ardhmen te jenë te kujdesshem dhe do te permbahen nga veprimet e tilla te karakterit penal, dhe me kete edhe do te arrihet qellimi i denimit i parapare sipas dispozitave te KP-se.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 1031/16 të dt. 18.09.2018**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder ketij aktgjykimi palet e pakenaqura kane te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.